



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS LEPOSAVIQ

Numri i lëndës: 2020:158140

Datë: 25.03.2024

Numri i dokumentit: 05501209

P.nr.133/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË -Dega në Leposaviq, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Marigona Lajqi, me bashkëpunëtoren profesionale Medina Rama, në çështjen penale ndaj të akuzuarit M. C., për shkak të veprës penale Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 371 par.3 e në lidhje me par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë- Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2017/20 e datës 27.11.2020, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me datë 29.02.2024, në prezencë të Prokurorit të Shtetit Arjan Xhema, palëve të dëmtuara R. N. dhe D. V., të akuzuarit M. C. dhe mbrojtësit të tij sipas detyrës zyrtare av. Festebardha Ismajli si dhe përkthyesit të gjykatës Hysen Mikullovc, me datë 04.03.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 25.03.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

M. C., nga i ati R., e ëma S., e vajzërisë D., i lindur me datë ..., në Rashkë, me vendbanim në fshatin S., komuna e Leposaviqit, me numër personal të identifikimit ..., i pa martuar, ka të përfunduar shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, serb, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datën 12.07.2020 diku rreth orës 20:40 në rrugën nacionale N-22,3 në komunën e Leposaviqit, saktësisht në vendin Kratinë, i pandehuri ka bërë shkelje të ligjit për rregullat e Komunikacionit rrugor 05/L-88, neni 41 dhe 233 në atë mënyrë duke drejtuar veturën e markës “Audi 4”, ngjyrë blu, me targa ..., në pronësi të V. J., duke drejtuar mjetin në gjendje të dehur prej 1,98g/kg alkool, ka kaluar nga traka e tij e ngasjes në trakën e kundërt, duke e goditur veturën – kamionetën e tipit “Scanija”, me tabela të regjistrimit ..., pronë e O. M., i cili ka qenë duke lëvizur në kahjen e kundërt nga drejtimi i Zveçanit në drejtim të Leposaviqit, ku për shkak të një përplasjeje së fortë kamioni ka humbur kontrollin dhe duke u rrokullisur kalon në trakën e kundërt, pas të cilës i pandehuri gjithashtu goditet me veturën e markës “Renault Megan” ngjyrë gri, me tabela të regjistrimit ..., të cilën e ka drejtuar D. V., e si pasojë e këtij aksidenti, lëndime trupore ka marr R. N., dhe atë: kontuzion i indeve të buta në zonën e klavikulës së djathtë, çarje e shkallës së dytë të nyjës së shpaullës AC, lëndime të shkaktuar nga goditje mekanike me një objekt të fortë dhe si të tilla bëjnë pjesë në lëndime të rënda fizike.

Me këtë ka kryer veprën penale : Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 371 par.3 në lidhje me par.1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të neneve: 1, 4, 7, 17, 21, 38, 40, 42, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 71, 72 e lidhur me nenin 371 par.3 në lidhje me par.1 të KPRK-së dhe neneve 364, 449, 452 të KPP-së, të akuzuarit, i:

SHQIPTON

- I. Dënim me burgim me kusht në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej dy (2) viteve, nga plotëfuqishmëria e këtij aktgjykimi.
- II. I akuzuari obligohet që në emër të shpenzimeve procedurale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej tridhjetë (30) euro, në emër të fondit të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej njëzet (20) euro, në emër të ekspertizës së komunikacionit shumën prej katërdhjetë euro e tetëdhjetë e tetë cent (40.88), si dhe në emër të ekspertizës

mjeko- ligjore shumën prej njëzet (20) euro, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. Palët e dëmtuara R. N. dhe D. V., kanë hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Mitrovicë- Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.2017/20 të datës 27.11.2020 ndaj të akuzuarit M. C., për shkak të veprës penale Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 371 par.3 në lidhje me par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 29.02.2024, në të cilën kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Arjan Xhema, të dëmtuarit R. N. dhe D. V., i akuzuari M. C. dhe mbrojtësja e tij sipas detyrës zyrtare av. Festebardha Ismajli si dhe përkthyesi i gjykatës Hysen Mikullovc.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, të akuzuarit i është dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me fajësinë, ashtu që në këtë seancë i akuzuari lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se e pranoj fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohem.

Prokurori i Shtetit Arjan Xhema lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se i propozoj gjykatës që t'ia pranoj pranimin e fajësisë të pandehurit, ngase pranimi i fajësisë është dhënë në mënyrë vullnetare, konform dispozitave ligjore të nenit 242 të KPP-së, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, pranimi i fajësisë ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Mbrojtësja e të pandehurit av. Festebardha Ismajli, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar: i propozoj gjykatës që ta pranoj pranimin e fajësisë ndaj të mbrojturit tim, pasi që ky pranim mbështetet në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, pranimi i fajësisë është bërë duke e ditur peshën e veprës penale, pa ndikim dhe me vullnetin e tij, dhe duke u konsultuar me mua si mbrojtëse, duke i pasur parasysh pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë.

I dëmtuari R. N., lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar: e mbështes pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale dhe nuk parashtoj kërkesë pasurore juridike dhe i gjithë dëmi më është kthyer.

I dëmtuari D. V., lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar: e mbështes pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale për shkak se më nuk kam pasur shqetësime nga i pandehuri dhe nuk parashtoj kërkesë pasurore juridike.

Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit mbështetet në provat të cilat i disponon kjo gjykatë si Procesverbali i marrjes në pyetje për të dëmtuarin D. V., i datës 13.07.2020, Procesverbali i marrjes në pyetje për të dëmtuarin R. N., i datës 13.07.2020, Procesverbali i marrjes në pyetje për të pandehurin M. C., i datës 16.07.2020, Raporti mjekësor për të dëmtuarin R. N., Procesverbali mbi ekzaminimin e pranisë së alkoolit, drogave apo barnave tjera në organizëm për të pandehurin M. C. i datës 12.07.2020, Procesverbali mbi ekzaminimin e pranisë së alkoolit, drogave apo barnave tjera në organizëm për të dëmtuarin R. N. i datës 12.07.2020, Procesverbali mbi ekzaminimin e pranisë së alkoolit, drogave apo barnave tjera në organizëm për të dëmtuarin D. V. i datës 12.07.2020, Fotoalbumi nga njësia rajonale e trafikut rrugor, e datës 12.07.2020, Raporti i aksidentit me numër 2020-ST-55, i datës 12.07.2020, Akt- ekspertimi mjeko- ligjor për të dëmtuarin R. N., i datës 11.11.2020, Ekspertiza e komunikacionit e datës 13.11.2020 si dhe shkresat e tjera të lëndës. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë të këtyre provave dhe pranimi të fajësisë, konsiderojmë se përtej çdo dyshimi është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në mënyrë vullnetare, dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, duke i' u tërhequr vërejtja të akuzuarit se pas pranimi të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të akuzuarit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i akuzuari M. C. ka kryer veprën penale: Ngasja në gjendje të paaftë

apo të dehur nga neni 371 par.3 në lidhje me par.1 të KPRK-së, e për të cilën veprë është paraparë dënimi me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

Me rastin e caktimit të dënimit, gjykata ka aplikuar dispozitat e zbutjes së dënimit, duke qenë se i akuzuari e ka pranuar fajësinë dhe në kuptim të nenit 71 par.1, nën par 1.3 të KPRK-së, kjo është rrethanë ligjore për zbutjen e dënimit. Në këtë situatë, atëherë gjykata, pasi i ka aplikuar dispozita e zbutjes së dënimit, në kuptim të nenit 48 të KPRK-së ka shqiptuar dënimin me kusht me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, me kohë të verifikimit prej 2 (dy) viteve ndaj të akuzuarit.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-ës. Gjkata, si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale nga i akuzuari në seancën e shqyrtimit fillestar, keqardhjen e shprehur dhe pendimin, , premtimin se nuk do të përsërisë më veprime të kundërligjshme, faktin se i ka kërkuar falje të dëmtuarve dhe janë pajtuar. Gjithashtu nga verifikimi i kryer në data bazën e Sistemit Qendror për Evidencë Penale, rezulton se i akuzuari nuk ka ndonjë Aktgjykim të formës së prerë, me çka vërtetohet se është hera e parë që i njëjti ka rënë ndesh me ligjin. Ndërsa, si rrethana rënduese, gjeti mënyrën e kryerjes së veprës penale, si dhe rrezikshmërinë e këtyre veprave penale.

Gjkata vlerëson se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit. Poashtu gjykata vlerëson se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit, i cili parashihet me nenin 38 të KPRK-së, që të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, duke vlerësuar se i akuzuari do të përmbahet nga veprimet e paligjshme në të ardhmen.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata e mori në kuptim të nenit 449 par 2 nën par 2.1 dhe 2.6 dhe nenit 452 të KPP-së. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 par. 3 nën. par 3.1 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 460 të KPPK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 364 dhe 452 të KPPK-ës, nga arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Dega në Leposaviq

Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni penal

P.nr.133/20, datë 25.03.2024

Gjyqtarja e vetme gjykuese

Marigona LAJQI

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh prej ditës së pranimi të këtij aktgjykimi përmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.